



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

Durrës, më 03.09.2025

NJOFTIM PËR RENDIN E DITËS
Mbledhje e Radhës

Në mbështetje të nenit 17, nenit 53, pika 2, të nenit 57 pika 2/c të Ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, të nenit 48, nenit 49 të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Durrës, Këshilli Bashkiak Durrës,

NJOFTON:

DITËN E MËRKURË, DATË 10.09.2025, ORA 13:00, KËSHILLI DO TË MBAJË NJË MBLEDHJE TË RADHËS, NË SALLËN E KËSHILLIT BASHKIAK Durrës, ME KËTË REND DITE:

****	MIRATIMI I RENDIT TË DITËS TË MBLEDHJES
Pika 1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit Komisioni Mandateve	PËR MIRATIMIN E MANDATIT TË ANËTARES SË KËSHILLIT BASHKIAK ZNJ. MIRELA RASIM SHALA
Pika 2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL 2025-2028, TË BASHKISË Durrës

Pika 3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PLANIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2026-2028 NË BASHKINË Durrës
Pika 4. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PROJEKTDOKUMENTIT TË PARË TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2026-2028 TË BASHKISË Durrës
Pika 5. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË Durrës, PËR MUAJIN GUSHT 2025
Pika 6. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 6.200.000 (GJASHTË MILION E DYQIND MIJË) LEKË PËR FURNIZIMIN ME ORENDI E PAJISJE TË SHKOLLËS SË MESME TË PËRGJITHSHME MANËZ, NJËSIA ADMINISTRATIVE MANËZ, SIPAS PROJEKTIT “FV ORENDI E PAJISJE GJIMNAZI MANËZ”
Pika 7. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK SI SUBJEKT I KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA MIDIS NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR RRITJEN E KAPACITETEVE TË QEVERISJES VENDORE, AKADEMIA E TRAJNIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (TALGA)
Pika 8. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NJË SHTESE NË PIKËN NR. 2 TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 66, DATË 25.06.2024 “PËR PËRCAKTIMIN E ZONAVE TË ADMINISTRIMIT TË PARKIMIT DHE TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË PARKIMIT ME PAGESË NË RRUGË DHE SHESHE NË TERRITORIN E BASHKISË Durrës”
*****	DISKUTIME DHE PYETJE NGA KOMUNITETI

Komisionet, që do të shqyrtojnë projektvendimin do të jenë:

Në mbështetje të nenit 33, nenit 34 pika 1, nenit 77 pika 8, të Rregullores së Funksionimit të Këshillit Bashkiak Durrës, anëtarët e Komisioneve të Këshillit Bashkiak pasi shqyrtojnë me njëri tjetrin projektvendimin përkatës, dorëzojnë propozimin e tyre (Raportin) mbi projektvendimin pranë zyrës së Sekretarit të Këshillit, sipas grafikut të mëposhtëm.

Datë 09.09.2025

Nr.	Komisionet që shqyrtojnë projektvendimet	Projektvendime pikat e rendit të ditës	Vendi i mbajtjes së mbledhjes	Ora
1.	Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike	2, 3, 4, 5, 6, 7, 8	Zyra Sekretarit të Këshillit	10.00
2.	Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike	8	Zyra Sekretarit të Këshillit	11.00
3.	Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave	4, 6	Salla e Këshillit	11.30
4.	Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit	3 , 6	Zyra Sekretarit të Këshillit	12.00
5.	Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit	2, 5	Zyra Sekretarit të Këshillit	13.00

Pika 1. Relatohet në mbledhjen plenare nga Komisioni i Mandateve.

SEKRETAR I KËSHILLIT BASHKIAK Durrës

Dorina Milja